<p>5. Medalja për Shërbim Besnikërie është medalje me ngjyrë të bronzte në formë të yllit tetëcepësh që në pjesën e epërme ka mbishkrimin zyrtar të Policisë së Kosovës ndërsa në qendër të medaljes ka stemën e Policisë së Kosovës dhe fjalët latine “Semper Fidelis” (“Gjithmonë Besnik”) në formë rrethore dekorative, në gjysmën e poshtme të medaljes. Medaljen e mban një shirit i përbërë prej dy vijave ngjyrë ari dhe të kaltër të mbyllët. Medalja e dytë është e argjendtë me të njëjtin dizajn. Medalja e tretë është medaljon ngjyrë ari me të njëjtin dizajn.</p>	<p>5. Orden za odanost u službi je Medalja bronzne boje u obliku osmokrake zvezde koji sa gornje strane ima službeni natpis Policije Kosova, dok na sredini ordena stoji grb Policije Kosova sa latinskim rečima “Semper Fidelis” (“Uvek odan”) na kružnom dekorativnom obliku, na donjoj polovini ordena. Orden drži traka sastavljena od dve prugaste linije zlatne i tano plave boje. Drugi orden je srebrni istim dizajnom. Treći orden je zlatne boje istim dizajnom.</p>	<p>5. The Medal for Loyalty Service is a bronze color medal, in the shape of eight-pointed star and at the upper part of it has the official inscription of Kosovo Police while in the center of medallion has the emblem of Kosovo Police with Latin words “Sempre Fidelis” (“Always Loyal”) in a circle decorative form at the half bottom of medallion. The medal is hanged in a ribbon which consist of two gold lines and dark blue. The second medal is silver with the same design. Third medal is a medallion with gold color with the same design.</p>
<p>6. Çdo medalje e dhënë nga Policia e Kosovës shoqërohet me një shirit pëlhure. Renditja dhe bartja e medaljeve dhe shiritave përcaktohet me këtë Udhëzim Administrativ.</p>	<p>6. Svaki dodeljeni orden od strane Policije Kosova ima platnenu traku. Redosled i nošenje ordena i traka odredjuje se ovim Administrativnim uputstvom.</p>	<p>6. Every medal awarded by the Kosovo Police is accompanied with a ribbon. Ranking and transfer of medals and ribbons is determined by this Administrative Instruction.</p>
<p>7. Me këtë medalje, zyrtari policor mund të dekorohet tri herë gjatë shërbimit.</p>	<p>7. Ovim ordenom policijski službenik može da se odlikuje tri puta tokom službovanja.</p>	<p>7. With this medal, the police officer can be decorated three times during the service.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 11 Renditja dhe bartja e medaljeve sipas përparësisë</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Redosled i nošenje medalja prema prednosti</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Sorting and wearing medals by priority</p>
<p>1.Renditja e Medaljeve të Shërbimit sipas përparësisë përcakton mënyrën e bartjes së tyre në uniformë. Renditja dhe bartja e medaljeve sipas përparësisë, nga më e larta deri te më e ulëta, është si vijon:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Medalja Mburojë e Policisë; 1.2. Medalja për Shërbim të Dalluar; 1.3. Medalja Policore për Lëvdim dhe 1.4. Medalja për Shërbim të Besnikërisë.</p> <p>2. Medaljet barten vetëm në uniformën zyrtare në raste solemne. Ato nuk barten në uniformën e punës, as në veshjen civile, përjashtimisht për zyrtarët publik në kostum civil, sipas standardit për veshje civile për përkthim. Të gjitha medaljet vihen në shirit të shkurtër dhe vendosen me radhë, sipas renditjes së përparësisë dhe vendosen mbi xhepin e majtë të këmbës ose të xhaketës.</p> <p>3.Shiritat për medaljet përkatëse mund të vendosen në cilëndo uniformë të shërbimit, duke përfshirë edhe uniformat e punës, përpos në veshjet sportive. Shiritat radhiten në një mbajtëse, më së</p>	<p>1. Redosled Medalja Službe prema prednosti odredjuje način njihovog nošenja na uniformi. Redosled i nošenje medalji prema prednosti, od najviše pa do najniže je sledeće:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Orden Štita Policije 1.2. Orden za Istaknuto Službovanje 1.3. Policijski Orden za Pohvalu 1.4. Orden za Odanost u Službi</p> <p>2. Medalje se nose samo na službenoj uniformi u svečanim prilikama. One se ne nose na radnoj uniformi, ni u civilu, izuzev za javne službenike u civilnoj odeći, prema standardu za civilnu odeću. Sve medalje se stavljaju na kratkoj traci i stavljaju se redom, po redosledu prednosti i stavljaju se na levom džepu košulje ili sakoa.</p> <p>3.Trake za dotične ordene mogu se postaviti u bilo koju uniformu službe obuhvatajući i radne uniforme osim u sportske odeće. Trake se naredjaju na jednom držaču, najviše tri u istom redu, prema redosledu</p>	<p>1. Sorting Service Medals by Priority determine the wearing manner in uniform. Lining and wearing medals by priority, from the highest to the lowest is as following:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Police Shield Medal; 1.2. Medal for Distinguished Service; 1.3. Police Medal for Praise and 1.4. Medal for Loyalty Service.</p> <p>2. Medals are worn only in the official uniform in solemn occasions. They are not worn in working uniform, neither on the civilian clothes, excluding the public officers in civilian costumes based on the standards of civilian clothes. All medals are put in a short ribbon and in ranging, and according to the priority order and they are put on the left pocket of the shirt or jacket.</p> <p>3.Ribbons for respective medals may be put at any uniform of the service, including working uniforms, except sport wearing. Ribbons are ordered in a holder, not more than three in a row, according to the</p>

<p>shumti tri në një rresht, sipas radhitjes së përparësisë dhe vendosen mbi xhepin e majtë të këmishës ose të xhaketës.</p> <p>4. As medaljet, as shiritat nuk barten në uniformën e patrullimit, në pelerinat e shiut ose në veshjet e tjera të jashtme, me përjashtim të xhemperit me jakë-V që është pjesë e uniformës, kur vishet me këmishë dhe kravatë.</p> <p>5. Kur bartet me tepër se një medalje a shirit, ato radhiten sipas përparësisë, duke filluar nga më e larta që vihet në anën e brendshme, ndërkaq në qendër vihet tjetra më e ulët se kjo, dhe në anën e jashtme vihet medalja ose shiriti më i ulët. Nëse bartet vetëm një medalje ose një shirit ai vendoset në qendër të mbajtëses, mbi xhep.</p>	<p>prednosti i postavljaaju se iznad levog džepa košulje ili sakoa.</p> <p>4.Ni ordeni niti trake se ne nose na uniformi patroliranja, na kišnim kabanicama ili na drugim spolašnjim odećama, izuzev džempera "V" kragom koji je deo uniforme kada se nosi uz košulju i kravatu.</p> <p>5. Kada se nosi više od jedan orden ili traka one se rasporedjuju prema prednosti počevši od najvišeg koji se stavlja sa unutrašnje strane, dok se na sredini stavlja niža od ove, i sa spoljašne strane stavlja se najniži orden ili traka. Ukoliko se nosi samo jedan orden ili traka onda se stavlja na sredini držača iznad džepa.</p>	<p>priority ranging and they are put on the left pocket of the shirt or jacket.</p> <p>4. Neither medals nor ribbons are worn on the patrolling uniform, in rain capes or in other outer clothing, except of the V shaped collar sweater that is a part of uniform, when worn with shirt and tie.</p> <p>5. When worn more than one medal or ribbon, they are ordered according to priority, starting from the highest that is put at the inner side, while at the center is put the lower one, and at the outer side is put the lowest medal or ribbon. If only one medal or a ribbon is worn, it is put in the center of the holder on the pocket.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Lëvdatat</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Pohvale</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Praises</p>
<p>Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ose personi të cilin ai e autorizon, u jep lëvdata pjesëtarëve të Policisë së Kosovës për vepra specifike, shërbim superior apo për shërbim shembullor ndaj komunitetit. Lëvdatat janë certifikata të gravura, të lëshuara në emër të Policisë së Kosovës, me kërkesë të mbikëqyrësit pas vërtetimit dhe miratimit nga zinxhiri komandues</p>	<p>Generalni Direktor Policije ili lice kojeg on ovlašćuje, dodeluje pohvale pripadnicima Policije Kosova za specifična superiorna dela ili za primerno službovanje prema zajednici. Pohvale su gravirane certifikacije, izdate u ime Policije Kosova, zahtevom predpostavljenog nakon utvrdjivanja i usvajanja od strane nadzornog komandnog lanca Policije Kosova.</p>	<p>General Director of Police or the person authorized by him gives praises to the members of Kosovo Police for specific works, superior service or for excellent service to the community. Praises are engraved certificates, issued on behalf of Kosovo Police, by the request of the supervisor after the certification and approval by the superior commanding</p>

<p>mbikëqyrës i Policisë së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Mirënjohjet</p> <p>1. Mirënjohjet mund të jepen nga: Shefi i Sektorit, Komandanti i Stacionit, Drejtori rajonal, Drejtori i Drejtorisë/Divizionit/Departamentit/, Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm apo Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Mirënjohjet jepen për zyrtarët policorë, zyrtarëve publik, kadetët policorë, personat fizik dhe juridik të vendit dhe të huaj që janë dalluar me meritat e tyre.</p> <p>2. Mirënjohjet, përdoren për ta dokumentuar dhe dëshmuar kryerjen e detyrave me profesionalizëm të lartë.</p> <p>3. Mirënjohjet duhet medoemos të jenë në pajtim me formatin dhe dizajnin e përshkruar në Aneksin 1 të këtij Udhëzimi. “Certifikatat për Mirënjohje” ose “Certifikatat për Lëvdata” të dizajnuara nga organizatat lokale apo diçka të ngjashme nuk janë të autorizuar të futen në dosjen personale të zyrtarit policor apo zyrtarit publik.</p> <p>4. Vetëm një mirënjohje duhet të shkruhet për secilin rast. Megjithatë ky Udhëzim nuk e ndalon as nuk e pengon një mbikëqyrës të secilit nivel që të</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Priznanja</p> <p>1. Priznanja mogu se dodeliti od: Šefa Sektora, Komandira Stanice, Regionalnog Direktora, Direktora/Divizije/Uprave, Zamenika Generalnog Direktora ili Generalni Direktor Policije. Priznanja se dodeljuju za policijske službenike, javne službenike, policijske kadete, domaća i strana fizička i pravna lica koji su se istakli svojim zaslugama.</p> <p>2. Priznanja, se koriste da bi utvrdili i dokazivali obavljanje zadataka za visokim profesionalizmom.</p> <p>3. Priznanja neophodno treba da su u skladu sa opisanom formatom i dizajnom u Aneksu 1 ovog Uputstva. “Certifikacije za priznanje” ili “Certifikacije za pohvale” dizajnirane i uradjene od strane lokalnih organizacija ili nešto slično nisu ovlašćene da se stave u lični dosije policijskog službenika, ili javnog službenika.</p> <p>4. Samo jedno priznanje treba da se piše za svaki posebni slučaj. Ipak ovo Uputstvo ne zabranjuje niti sprečava jednog nadzornika svakog nivoa da pripremi neko priznanje ili</p>	<p>chain of Kosovo Police.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Recognitions</p> <p>1. Recognitions can be given by the Chief of Section, Station Commander, Regional Director, Director of Directorate/Division/Department, Deputy General Director or General Director of Police. Recognitions are given to the police officers, public officials, police cadets, physical and judicial persons of the country or foreigners who are distinguished with their merits.</p> <p>2. Recognitions can also be used to document and prove the performance of duties with high professionalism.</p> <p>3. Recognitions should necessarily be in accordance with the design or format described in Annex 1 of this Instruction. There is no authorization for “Certifications for Recognition” or “Certifications for Praises” designed by the local organizations or something similar, to be put in the personal dossier of the police or public officials.</p> <p>4. Only one recognition must be written for each case. However this Instruction does not prevent or hinder a supervisor of any level to prepare any recognition or</p>
---	--	--

<p>përgatisë ndonjë mirënjohje ose të paraqesë rekomandim formal për ndonjë lëvdatë apo medalje zyrtare, nëse rrethanat e justifikojnë një rekomandim të tillë.</p> <p>5. Kopjet e të gjitha mirënjohjeve duhet të dërgohen dhe vendosen në dosjet personale të përhershme të personelit të Policisë.</p>	<p>da podnosi formalnu preporuku za neku pohvalu ili službeni orden, ukoliko okolnosti opravdavaju jednu takvu preporuku.</p> <p>5. Primerak svih priznanja treba da se dostave o stave u ličnim trajnim dosijeima Policije.</p>	<p>submit a formal recommendation for any praise or official medal, if the circumstances justify such a recommendation.</p> <p>5. Copies of all recognitions must be submitted and put in the permanent personal dossiers of the Police personnel.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Shpërblimet e tjera</p> <p>1. Zyrtarët policorë kanë mundësi të shpërblehen disa herë me të njëjtën medalje, duke u bazuar në standarde të njëjta në bazë të të cilave është shpërblyer për herë të parë.</p> <p>2. Zyrtari policor duhet ta bartë në uniformë vetëm një shirit për një medalje të një kategorie. Nëse polici shpërblehet për herë të dytë me medalje të njëjtë, atëherë ka të drejtë ta vendosë një yll të argjendtë pesëcepësh në mes të shiritit, dhe nëse i njëjti e fiton për herë të tretë të njëjtën medalje, kjo i jep të drejtë që ai ta vendosë në shirit një yll të artë pesëcepësh.</p> <p>3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë është kompetent të vendos për rregullat se</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Druga nagradjivanja</p> <p>1. Policijski službenici imaju mogućnost da se nagrade više puta istom medaljon, na osnovu istih standarda na osnovu kojih je nagradjen po prvi put.</p> <p>2. Policijski službenik treba da nosi u uniformi samo jednu traku za jednu medalju jedne kategorije. Ukoliko se policajac nagradi po drugi put sa istm medaljon tada on ima pravo da stavi srebrnu petokraku zvezdu na sredini trake i ukoliko isti dobija i po treći put istu medalju ona daje mu za pravo da stavi na traci zlatnu petokraku zvezdu.</p> <p>3. Generalni Direktor Policije treba da odredjuje gde treba da se postave ordeni iste</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Other awards</p> <p>1. Police officers may be awarded several time with the same medal, based on the same standards that the officer has been awarded for the first time.</p> <p>2. The Police officer must wear in the uniform only a ribbon for a medal of a category. If the police officer who is awarded for the second time with the same medal, has the right to place a silver five pointed star in the middle of the ribbon, and if the same officer wins the same medal for the third time, this gives him the right to place a golden five pointed star in the ribbon.</p> <p>3. General Police Director is competent to set rules on how the medals of the same</p>

<p>si duhet të vendosen dhe barten medaljet e të njëjtës kategori.</p> <p>4. Krahas medaljes Policia e Kosovës do t'i ndajë edhe një shumë të mjeteve financiare për tri (3) medaljet si më poshtë:</p> <p>4.1. Medalja për Lëvdatë stimulimi shtesë është 250 euro.</p> <p>4.2. Medalja për shërbim të dalluar stimulimi shtesë është 300 euro.</p> <p>4.3. Medalja për mburojë të policisë stimulimi shtesë është 350 euro.</p> <p>5. Për mbështetjen e këtij Udhëzimi administrativ Policia e Kosovës duhet të planifikojë një fond të veçantë të planifikuar për shpërblime.</p> <p>6. Po ashtu zyrtarët policorë mund të pranojnë shpërblime tjera nga agjencionet e zbatimit të ligjit të Republikës së Kosovës të parapara me aktet ligjore për shpërblime të zyrtarëve që japin rezultate në zbulimin dhe parandalimin e veprave të rënda penale.</p> <p>7. Drejtori i Përgjithshëm mund të shpërblejë materialisht personelin policor në rastet kur ata kryejnë punë të dalluar që tejkalojnë suazat normale të kryerjes</p>	<p>kategorije steçene po trëci put ili i nakon trećeg puta.</p> <p>4. Pored medalje, Policija Kosova podeliće i izvestan iznos finansijskih sredstva za tri (3) dole navedene medalje:</p> <p>4.1. Medalju za pohvalu dodatna stimulacija je 250 €.</p> <p>4.2. Medalju za primerno službovanje dodatna stimulacija je 300 €.</p> <p>4.3. Medalja za štit Policije dodatna stimulacija biće u iznosu od 350 €.</p> <p>5. Za podršku ovog administrativnog uputstva, Policija Kosova treba da planira poseban planirani fond za nagrade</p> <p>6. Takodje policijski službenici mogu primiti druge nagrade od strane agencija primenjivanja zakona Republike Kosova predvidjene zakonskim aktima za nagradjivanje službenika koji daju rezultate na otkrivanje i suzbijanje teških krivičnih dela.</p> <p>7. Generalni Direktor može materijalno da nagradi policijsko osoblje u slučaju kada oni izvršavaju primeran rad koje proizilaze normalne okvire obavljanja zadataka.</p>	<p>category be put and wear.</p> <p>4. Along the medal, Kosovo Police will also award an amount of financial funds for three (3) following medals:</p> <p>4.1. For the medal of Praise additional simulation is 250 euro.</p> <p>4.2. For the medal of Distinguished Service, additional simulation is 300 euro.</p> <p>4.3. The Medal for Police Shield, additional simulation is 350 euro.</p> <p>5. For support of this Administrative Instruction, Kosovo Police shall plan a special fund aimed for awards.</p> <p>6. Police officers may also receive other awards from the law enforcement agencies of the Republic of Kosovo foreseen by the legal acts for awards of officers who give results in detection and prevention of serious criminal acts.</p> <p>7. General Director may also reward the police personnel materially in cases when they perform distinguished work that exceeds the normal frames of performing</p>
---	---	---

<p>së detyrave.</p> <p>7.1. Propozimet për shpërblimet e tilla materiale bëhen duke aplikuar procedurat e njëjta që parashihen në nenin 4, paragrafi 3,4 dhe 5 të këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>7.2. Shpërblimet materiale nga pika 7.1. e këtij neni ndahen sipas kriterëve që përcakton neni 14, paragrafi 4, i këtij udhëzimi administrativ, kur për këtë lejohet mundësitë buxhetore.</p>	<p>7.1. Predlozi za takve materijalne nagrade su napravljeni primenom iste procedure predviđene u članu 4, stav 3, 4 i 5 ovog administrativnog uputstva.</p> <p>7.2. Materijalne nagrade iz tačke 7.1. ovog člana su dodeljuju se u skladu sa kriterijumima koje odredjuje članom 14, stav 4, ovog Administrativnog uputstva, kada za to dozvoljavaju budžetske mogućnosti.</p>	<p>duties.</p> <p>7.1. Proposals for such material rewards are done by applying the same procedures, foreseen in article 4, paragraph 3,4 and 5 of this Administrative Instruction.</p> <p>7.2. The material rewards from the point 7.1 of this article are given according to the criteria determined by article 14, paragraph 4, point 4.1 of this Administrative Instruction, when there is budget available.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15</p> <p style="text-align: center;">Revokimi dhe rikthimi në gjendjen e mëparshme</p> <p>1. Mbikqyrësit brenda strukturës së policisë si dhe personat fizik dhe juridik mund të iniciojnë propozimin për dhënie të medaljes sipas nenit 4 të këtij udhëzimi administrativ dhe me të njëjtën procedurë mund të iniciojnë kërkesë te Drejtori i Përgjithshëm i Policisë për revokim apo rikthim në gjendjen e mëparshme.</p> <p>2. Arsyeja për revokimin e shpërblimit ka të bëjë me krijimin e bindjes që marrësi i medaljes ka humbur nderin dhe besimin tek të tjerët.</p> <p>3. Drejtori i Përgjithshëm themelon</p>	<p style="text-align: center;">Član 15</p> <p style="text-align: center;">Revokacija i ponovno vraćanje u prethodno stanje</p> <p>1. Nadzornici unutar strukture policije kao fizička i pravna Lica mogu da iniciraju predlog za dodelu medalje prema članu 4 ovog Administrativnog Uputstva i istom procedurom mogu inicirati zahtev kod Generalnom Direktoru Policije za povratak u prethodno stanje.</p> <p>2. Razlog za revokaciju nagrade radi se o stvaranju ubedjenja da je primaoc medalje izgubio je čast i poverenje kod ostalih.</p> <p>3. Generalni Direktor Policije formira</p>	<p style="text-align: center;">Article 16</p> <p style="text-align: center;">Revocation and return at the previous state</p> <p>1. The supervisor within the police structure as well as natural and legal Persons can initiate proposal for giving medal according to the paragraph 4 of this administrative instruction and with the same procedure may initiate the request to the General Director of Police for revocation or return to the previous state.</p> <p>2. The reason for revoking the award is about creation of belief that the medal receiver has lost the honor and trust to the others.</p> <p>3. General director establishes the</p>

<p>Komision për shqyrtimin e fakteve, rrethanave si dhe të dhënave plotësuese që e mbështesin propozimin për revokim të medaljes së dhënë.</p> <p>4. Komisioni gjatë shqyrtimit të fakteve mund të kërkojë nga marrësi i medaljes një raport me të dhëna mbi bazueshmërinë apo mosbazueshmërinë e propozimit për revokim të medaljes së tij.</p> <p>5. Komisioni pas shqyrtimit të fakteve rekomandon te Drejtori i Përgjithshëm i Policisë miratimin apo refuzimin e propozimit për revokim të medaljes së dhënë.</p> <p>6. Marrësi i medaljes i cili është informuar nga Komisioni për revokimin e medaljes, obligohet ta kthejë atë (përfshirë pjesët përbërëse) sa më shpejtë që është e mundshme.</p> <p>7. Moskthimi i medaljes paraqet shkelje të rëndë disiplinore dhe i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore.</p>	<p>Komisiju za razmatranje činjenica , okolnosti kao i dodatnih podataka koje podržavaju predlog za revokaciju date medalje</p> <p>4. Komisija tokom razmatranja činjenica može da zahteva od primaoca medalje jedan pismeni izveštaj sa podacima o osnovavnog ili neosnovanog predloga za revokaciju njegove medalje.</p> <p>5. Komisija posle razmatranja činjenica preporučuje Generalnom Direktor Policije usvajanje ili odbijanje preoruke za revokaciju date medalje.</p> <p>6. Dobitnik medalje koji je informisan od strane Komisije za revokaciju medalje obavezuje se da je vrati (obuhvatajući sastavne delove) što je pre moguće.</p> <p>7. Ne vraćanje medalje predstavlja tešku disciplinsku povredu i predmet je disciplinske odgovornosti.</p>	<p>Committee for review of facts, circumstances as well as additional data that support the proposal for revocation of given medal.</p> <p>4. The committee during reviewing facts, may require by the medal receiver a report with the data on the implementation or non-implementation of proposal for revocation of his medal.</p> <p>5. The committee after reviewing facts, recommends to the General Director of Police the approval or refusal of proposal for revocation of given medal.</p> <p>6. Medal receiver who is informed by the Commission for medal revocation, is obliged to return it (including integral parts) as soon as possible.</p> <p>7. Failure to return the medal constitutes a serious disciplinary violation and is subject to disciplinary process.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Medalja e humbur apo e dëmtuar</p> <p>Marrësi i medaljes i cili e ka humbur, dëmtuar apo i është vjedhur medalja mund të bëjë kërkesë me shkrim tek</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Izgubljena ili oštećena Medalja</p> <p>Dobitnik Medalje koji je izgubio, oštetiio ili kome je ukradena medalja može da pismeno zahteva kod Direktora Uprave za Ljudske</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Lost or damaged medal</p> <p>Medal receiver, who lost, damaged or to whom the medal is stolen, can make a written request to the Director of</p>

<p>Drejtori i Departamentit për Burime Njerëzore për zëvendësim të medaljes, përderisa nuk parashihet ndryshe. Shpenzimet për rastet e tilla barten nga Policia e Republikës së Kosovës.</p>	<p>Izvore za zamenu Medalje, sve dok se drugačije ne predvidi. Troškove za takve slučajeve snosi Policija Republike Kosova.</p>	<p>Department for Human Resources for medal replacement, until it is foreseen otherwise. The expenses for such cases are carried out by the Police of the Republic of Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 Procedura Standarde e Operimit</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Standardna Operativna Procedura</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Standard Operating Procedure</p>
<p>Me Procedurë Standarde të Operimit (PSO) Departamenti për Burime Njerëzore, më gjerësisht dhe në mënyrë më të detajuar do t'i rregullojë procedurat dhe rregullat të cilat kanë të bëjnë me dhënien e medaljeve, lëvdatave dhe mirënjohjeve.</p>	<p>Standarndnom Operativnom Procedurom (SOP) Uprava za Ljudske Resurse opširnije i detaljnije će regulisati procedure i pravila koja se odnose na dodeljivanje medalja, pohvala i priznanja.</p>	<p>With the Standard Operating Procedure (SOP), the Department of Human Resources will regulate further and in more detail the procedures and rules related to the awarding of medals, praises and recognitions.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 18 Aneksset</p>	<p style="text-align: center;">Član 18 Aneksi</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 Annexes</p>
<p>Pjesë të këtij udhëzimi administrativ janë: Aneksi 1 Mënyra e bartjes së medaljeve –foto 1 &2; Aneksi 2 Udhëzimet për kompletimin e propozimit për shpërblim nga Policia; Aneksi 3 Propozimi për shpërblim nga Policia; Aneksi 4 Mirnjohje; Aneksi 5 Llojet e medaljeve nga Policia; Aneksi 6</p>	<p>Deo ovog administrativnog uputstva su: Aneks 1 Način nošenja medalji-slika 1&2; Aneks 2 Uputstva za kompletiranje predloga za nagradjivanje od Policije; Aneks 3 Predlog z anagradjivanje od Policije; Aneks 4 Priznanje; Aneks 5 Vrste medalji od Policije; Aneks 6</p>	<p>Parts of this administrative instruction are: Annex 1 Manner of wearing medals –photo 1 &2; Annex 2 Instructions for completing the reward proposal from the Police; Annex 3 The proposal for reward from Police; Annex 4 Recognitions; Annex 5 Types of medals from Police; Annex 6</p>



<p>Propozimi për revokim nga Policia; Aneksi 7 Forma e vendimit për shpërblim të medaljes; Aneksi 8 Forma e vendimit për revokim të medaljes.</p> <p style="text-align: center;">Neni 19 Dispozitat shfuqizuese</p> <p>Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ me Nr. 02/2016, me datë 21/07/2016 për Medaljet, lëvdatat, shpërblimet dhe mirënjohjet.</p> <p style="text-align: center;">Neni 20 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.</p> <p>Z. Samedin Mehmeti</p>  <p>Drejtor i Përgjithshëm i Policisë</p> <p>11/01/2022</p>	<p>Predlog za revokaciju od Policije; Aneks 7 Obrazac rešenja o nagrade medalje. Aneks 8 Obrazac rešenja o revokaciji medalje.</p> <p style="text-align: center;">Član 19 Ukidajuće odredbe</p> <p>Stupanjem na snazi ovog Administrativnog Uputstva se ukida Administrativno Uputstvo Br.02/2016, dana 21/07/2016 o Medaljama, Pohvalama i Priznanjima.</p> <p style="text-align: center;">Član 20 Stupanje na smagu</p> <p>Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu nakon potpisivanja od strane Generalnog Direktora Policije.</p> <p>G. Samedin Mehmeti</p>  <p>Generalni Direktor Policije</p> <p>11/01/2022</p>	<p>Proposal for revocation by the Police; Annex 7 Medal for awards decision form. Annex 8 Medal for revocation decision form.</p> <p style="text-align: center;">Article 19 Abrogation provisions</p> <p>By entering into force of this Administrative Instruction, the Administrative Instruction No. 02/2016, dated 21/07/2016 on Medals, praises, awards and recognitions is abrogated.</p> <p style="text-align: center;">Article 20 Effective date</p> <p>This Administrative instruction will be effective after signing by the General Police Director.</p> <p>Mr. Samedin Mehmeti</p>  <p>General Police Director</p> <p>11/01/2022</p>
---	--	--

Figura 1. Bartja medaljeve, Figure 1. Wearing the Medals Slika 1. Nošenje ordenja





Figura 2 – Bartja e shiritave, Figure 2 – Wearing the Ribbons, Slika 2 – Nošenje traka

UDHËZIME PËR KOMPLETIMIN E

PROPOZIMIT PËR SHPËRBLIM NGA POLICIA

1. Formulari i bashkangjitur duhet të plotësohet nga mbikëqyrësi që e bën propozimin e zyrtarit policor, zyrtarit publik, kadetit policor, personit juridik i vendit dhe i huaj që e ka dalluar veten në kryerje të detyrës.

Nuk duhet ta dorëzoni këtë formular nëse shpërblimi është "Mirënjohje", nga niveli lokal.

Formulari origjinal duhet të jetë me ngjyrë të kaltër, të jetë i lexueshëm, dhe t'i përmbajë të gjitha faktet e domosdoshme për ta arsyetuar në tërësi shpërblimin/medaljen për të cilën propozohet. Komisioni për Shpërblime shqyrton rastin, duke u mbështetur në të dhënat që posedon.

Mund t'i bashkëngjitni pesë (5) faqe shtesë në lidhje me dokumentacionin që do ta shqyrtojë Komisioni, faqe të cilat nuk duhet të tejkalojnë.

Përpilimi i Formularit

2. Zgjidhni medaljen apo shpërblimin për propozim ku zyrtari policor zyrtari publik, kadeti policor, personi juridik i vendit dhe i huaj ka dalluar veten në kryerje të detyrës.

Kujdesuni që t'i keni lexuar, analizuar dhe kuptuar në tërësi kriteret të cilat duhet të përmbushen për të autorizuar atë medalje/shpërblim përkatës.

3. Mos e njoftoni zyrtarin policor zyrtarin publik, kadetin policor, personin juridik të vendit dhe të huaj, për shpërblimin specifik që është rekomanduar ai/ajo sepse është e mundur të ndodh që Komisioni të aprovoj ndonjë shpërblim më të ulët.

Të mos harrohet se – shtatë (7) shpërblimet e para aktualisht janë medalje të shoqëruara me shirita. Dy shpërblimet pasuese janë përkatësisht mirënjohje me shkrim të futura në kornizë që nuk shoqërohen me medalje apo shirit.

Pjesa e parë- Incident apo Veprim

Shëno kohën, datën, dhe vendin ku ka ndodhur incidenti, shërbimi, apo aksioni. Të jeni sa më konkret që është e mundur. Të përfshihen të gjitha faktet si (me rastin e ndonjë incidenti): a kanë qenë personat në fjalë të armatosur, si kanë qenë të armatosur, a ka qenë personi i sulmuar, i lënduar, i gjymtuar, etj. (me rastin e kryerjes së ndonjë shërbimi të posaçëm) çka është arritur me atë rast, çka kanë përfituar qytetarët, Policia, a ka qenë prezent ndonjë përfaqësues i njohur i shtypit ose mediave vendore apo ndërkombëtare, a ka qenë ky një akt i shkëlqyeshëm dhe i jashtëzakonshëm i profesionalizmit policor; (me rastin e ndonjë aksioni të posaçëm) a ka qenë akt heroik, që i tejkalon kufijtë profesional të obligimeve të policit ndaj detyrës, a është shpëtuar ndonjë jetë, -nëse po, kujt i është shpëtuar jeta, moshë, rrethanat për një veprim të tillë, a ka ekzistuar kërcënimi evident për jetën dhe mirëqenien e policit- nëse po, të shënohet saktë mënyra e kërcënimit.

Pjesa e dytë- Teksti

Shkruaje një “mostër” për tekstin i cili sipas mendimit tuaj e përshkruan në tërësi incidentin, aksionin e zyrtarit policor zyrtarit publik, kadetit policor, personit juridik i vendit dhe i huaj që e kanë dalluar veten dhe kanë treguar profesionalizëm të lartë.

Shembull:

Me 23 Mars 2002, derisa ishte në detyrë në Rajonin e Prishtinës, zyrtari policor apo zyrtari publik, kadeti policor, personi juridik i vendit dhe i huaj _____ takoi një

(shëno emrin personal)

individ i cili ishte i armatosur me revole gjysmë-automatike, derisa ishte duke plaçkitur një tregtar vendor, me ç'rast kishte ardh edhe deri tek gjuajtja me armë. Duke parë se tregtari ishte lënduar rëndë, dhe duke mos menduar në sigurinë dhe mirëqenien e vet personale, zyrtari policor apo zyrtari publik, kadeti policor, personi juridik i vendit dhe i huaj, e mposhti sulmuesin e armatosur në një shkëmbim zjarri, dhe i ofroi të lënduarit ndihmën e parë deri sa erdhi ndihma profesionale mjekësore. Aksionet e zyrtarit policorë/apo zyrtari publik, kadetit policor, personit juridik i vendit dhe i huaj janë në përputhje me standardet më të larta të profesionalizmit të Policisë së Kosovës.

Pjesa e tretë - Dëshmitarët/Pjesëmarrësit

Të regjistrohen të gjithë personat të cilët ishin prezent apo që kanë informata të sigurta lidhur me incidentin, aksionin apo shërbimin që është ofruar.

Shënoji informatat për kontakt (adresat, njësitet, numrat e telefonit etj.), për ta ndihmuar Komisionin për shpërblime dhe personelin administrativ.

Pjesa e katërt - Rekomandimi

Çdo mbikëqyrës është i obliguar ta arsyetoj propozimin e vet. Pse është shpërblimi i propozuar i përshtatshëm, pse duhet këto akte dhe shërbime të shpërblehen zyrtarisht me medalje/shpërblim, e jo vetëm me Mirënjohje nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Policisë apo Drejtori i Departamentit, çka e shquan këtë akt mbi aksionet e kryera nga ky zyrtar policor/zyrtarit tjetër i Policisë, nga veprimet e rregullta të Policisë.

Pjesa e pestë - Aprovimi

Mbikëqyrësi propozimin për shpërblim e dërgon përmes zingjirit komandues tek Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Policisë apo tek Drejtori i Departamentit. Propozimet jo të kompletuara sipas kriterëve të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ nuk pranohen.

Drejtori Rajonal i Policisë duhet që të kujdeset para se të jap pëlqimin e tij/saj, se propozimi është bërë në pajtim me kriteret e përcaktuara me këtë Udhëzim.

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova Ministry of Internal Affairs Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police	
	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/ Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate	

PROPOZIM PËR SHPËRBLIM NGA SHËRBIMI

Të dhënat e propozuesit (mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë) për shpërblim:

Emri dhe Mbiemri _____
 Grada _____
 Nr.i KI _____
 Departamenti/Divizioni/Drejtoria: _____
 Njësia/stacioni: _____
 Nr i tel kontaktues: _____

Të dhënat e punonjësit të propozuar për shpërblim:

Emri dhe Mbiemri _____
 Grada _____
 Nr.i KI _____
 Departamenti/Divizioni/Drejtoria: _____
 Njësia/stacioni: _____

Lloji i propozimit për shpërblim:

- Medaljen Mburojë e Policisë,
- Medalje për Shërbim të Dalluar,
- Medaljen Policore për Lëvdim,
- Medaljen për Shërbim të Besnikërisë,
- Lëvdatë
- Mirënjohje .

PJESA 1: – INCIDENTI APO VEPRIMI (Përshkruaj në mënyrë kronologjike rrethanat e incidentit)

Propozimi është shqyrtuar nga Drejtori i Drejtorisë/Divizionit:

Emri dhe Mbiemri: _____
Grada: _____ Nr.i KI: _____ Pozita: _____
Drejtoria /Divizioni Departamenti : _____
Nr. i tel kontaktues: _____
Komentet: _____
Nënshkrimi: _____

Propozimi përmes zinxhirit komandues është percjellur në nivel më të lartë për shqyrtim te Drejtori i Departamentit:

Emri dhe Mbiemri: _____
Grada: _____ Nr.i KI: _____
Departamenti : _____
Nr. i tel kontaktues: _____
Komentet: _____
Nënshkrimi: _____

Vendimi i Komisionit për Shpërblime:

- Aprovon propozimin e autoritetit propozues.
- Nuk aprovon propozimin e autoritetit propozues.
- Aprovon pjesërisht propozimin e autoritetit propozues–vendos për llojin tjetër të medaljes nga ai i propozuar.
- Aprovon pjesërisht propozimin e autoritetit propozues-kthen propozimin për shqyrtim në nivel lokal.

Vendimi është marr ne mënyrë **Unanime**

Vendimi është marrë **Me shumicë votash**

Nënshkrimi i kryesuesit dhe anëtarëve të panelit shqyrtues:

Grada, Emri dhe Mbiemri _____ Anëtar, Nënshkrimi: _____

Grada, Emri dhe Mbiemri _____ Anëtar, Nënshkrimi: _____

Grada, Emri dhe Mbiemri _____ Anëtar, Nënshkrimi: _____

Vëmendje: Në këtë formular duhet të shënohen të gjitha faktet dhe rrethanat që i kanë paraprirë propozimit dhe t'i bashkëngjiten të gjitha dokumentet relevante dhe pastaj të përcillet përmes zinxhirit komandues në Komisionin për Shpërblime.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Mirënjohje

Për

(shënohet emri dhe mbiemri i zyrtarit policor ose i zyrtarit publik të Policisë)

Dëshiroj të ju lavdëroj zyrtarisht dhe shpreh mirënjohje për kryerjen shembullore dhe profesionale të detyrës gjatë punës suaj në _____

prej datës _____, deri më _____, në pozitën e _____
(shënohet emri i njësisë)

(shëno pozitën)

(njësia organizative-drejtoria)

Gjatë punës suaj, keni treguar aftësi udhëheqëse, pjekuri dhe profesionalizëm të nivelit të lartë ashtu siç pritet prej pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Ju ishit tejet i dobishëm në përpilimin e një programi të shkëlqyeshëm për trajnim në terren për policët të cilët janë emëruar të punojnë në njësinë tuaj, keni marrë iniciativën në vendosjen e marrëdhënieve të shëndosha me komunitetin dhe keni organizuar formimin e një grupi këshillues të qytetarëve për ta ndihmuar Drejtorin Rajonal të Policisë.

Ju uroj suksese të mëtejme në karrierën tuaj si anëtar i vyeshtëm i Policisë dhe në detyrat vijuese.

Një kopje e kësaj mirënjohje do të mbetet në dosje personale.

Më datën

